

VENDIM
Nr. 528, datë 13.6.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION
TË NDËRTIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË PORTIT TË JAHTVE PRANË URËS SË
DAJLANIT, DURRËS, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE
KONKURRUESE, QË I JEPET SUBJEKTIT “ADRIATIC YACHTING MARINA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pikat 1 dhe 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të ndërtimit të portit të jahtve pranë Urës së Dajlanit, Durrës, është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.
2. Koncesioni do të jetë i formës BOT (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit).
3. Miratimin e bonusit, prej 8% të pikëve, për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor, në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet subjektit “Adriatic Yachting Marina”.
4. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha